

UDHËZIM
Nr.2209, datë 25.11.2010

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.277, DATË 18.7.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.277, datë 18.7.1997 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.277, datë 18.7.1997, është 10 200 (dhjetë mijë e dyqind) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin nga data 1.12.2010.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera